

# INSTITUTI HIDROMETEOROLOGJIK I KOSOVËS

## SITUATA DHE PROGNOZA HIDROLOGJIKE NË KOSOVË

Reshjet intensive të shiut gjatë këtyre ditëve, janë si pasojë e ciklonit të ardhur nga pjesa veri-perëndimore e Kontinentin Evropian, në të cilin është përfshi edhe vendi jonë nga një mot i përcjellur me reshje shiu të intensiteti të lartë, sidomos nga data 04, duke arritur maksimumin gjatë datës 5 dhe 6 shkurt 2015, me intenzitet me të theksuar të shpërndarjes kohore dhe hapësinor sidomos në pjesën perëndimore dhe qendrore të Gadishullit Ballkanik. Këto të reshura, kanë shkaktuar ngritjen e shpejt të nivelit të ujit të lumenjve të Kosovës të cilët janë të vrullshëm, për shkak të karakterit malorë të tyre, ku si pasojë shumica e tyre kanë ndalur nga shtrati duke shkaktuar përmytje në disa zona të Kosovës.

Situata hidrologjike është pothuajse e njëjtë në tërë territorin e Kosovës, por më tepër e rënduar është në pellgun e Lumit Sitnica, duke përfshi shumicën e ujërrjedhave të sajë nga të dyja anët, duke filluar nga pjesa qendrore e fushëgropës së Kosovës (Lypjani dhe rrethina e sajë, Fushë Kosova, Obiliqi, Vushtrria) etj. Edhe dega e djathtë e Sitnicës Lumi Llap, në rrjedhën e tij të mesme dhe sidomos në atë të poshtme (Lluzhan, Lupç i Ulët) etj, duke përmytur tokat në të dy anët e sajë.

Problematike paraqiten rrjedhat malore me karakter rrëkesh (prrockat, prrojet) etj të cilat për shkak të konfiguracionit të relievit, kanë karakter vërshues duke shkaktuar dëme nëpër disa fshatra dhe lagje qytetesh, në disa vise të Kosovës.

Situatë pothuajse e njëjtë paraqitet edhe në pjesën Lindore të Kosovës, në pellgun e Moravës së Binçës, sidomos në rrjedhën e mesme dhe të poshtme të ijë, duke ndalur nga shtrati nga vendbanimet: Budrik e Ulët, Lladovë, Dobërçan, Rranillug, Korminjan, pastaj Kriva Reka në Domaroc dhe rrjedhat e saja nga ana e majtë (lumi i Hogoshtit, Hodonocit, Karaçevës etj) ku si pasoj disa shtëpi nëpër disa fshatra janë të përmytura nga uji dhe janë shkaktuar dëme në infrastrukturën rrugore.

### PROGNOZA HIDROLOGJIKE PËR DITËT NË VIJIM

Nga data 08/02/2014, niveli dhe prurjet e ujit nëpër shumicën e lumenjve të Kosovës kanë stagnuar, ndërsa në disa prej tyre edhe të bien. Tendencat në vazhdim do të jen në ulje të vazhdueshme, të cilat do të reflektohen pozitivisht në tërheqjen e ujit të lumenjve nëpër shtretërit e tyre, ndërsa ndërprerja e reshjeve të shiut gjatë ditëve në vazhdim, do të ndikoj në përmirësimin e përgjithshme të kushteve hidrologjike në vend.

Tabela 1 Situata hidrologjik dhe tendencat për disa lumenj të Kosovës për ditët në vijim

N r	LUMI	STACIONI	PELLGU	SITUATA		TENDENCAT HIDROLOGJIKE				
				7-8/02/2015		09/02/2015	10/02/2015	11/02/2015	12/02/2015	
1	Drini Bardhë	Gjonaj	Drini							
2	Bistrica Pejës	Grykë e Rugovës	Drini Bardhë							
3	Bistrica e Prizrenit	Prizren	Drini Bardhë							
4	Ereniku	Gjakovë	Drini Bardhë							
5	Mirusha	Këpuz	Drini Bardhë							
6	Sitnica	Vragoli	Ibri							
7	Llap	Lluzan	Sitnica							
8	Lepenci	Brod	Lepenc							
9	Lepenci	Hani Elezit	Lepenc							
10	Nerodimka	Kaçanik	Lepenc							
11	Morava Binçs	Viti	Morava							
12	Morava Binçs	Konçul	Morava							

**Legjenda:**

	Rritje e konsiderueshme e nivelit të ujit
	Rritje e nivelit të ujit
	Stagnim i nivelit të ujit
	Rënie e nivelit të ujit
	Rënie e konsiderueshme e nivelit të ujit

**Vërejtje:** pas datës 12/02/2014, pritet ngritje e ngadalshme e nivelit të ujit nëpër lumenj, për shkak të fillimit të shkrirjes së borës, intensiteti i shkrirjes dhe sasia e borës nuk paraqesin paradispozita për përmbytje eventuale.

1. Niveli i ujit të Drinit Bardhë stacioni hidrometrik në Gjonaj gjatë datës 09/02/2015 në ora 10<sup>00</sup> ishte 210 Cm, me tendencë të bjerë gjatë katër ditëve të ardhshme. Situata e njëjtë është në disa nga degët kryesore të sajë, sidomos nga ana e djathtë  
Gjatë ditëve të ardhshme do të ketë rënie të ngadalshme të nivelit të ujit nëpër lumenj.
2. Lumi Bistrica e Pejës stacioni Hidrometrik në Grykë të Rugovës, më datën: 09/02/2015, në ora 15, ishte 61 Cm, është në rënie të ngadaltë, me një tendencë në rënies së edhe gjatë katër ditëve të ardhshme.
3. Niveli i ujit në lumin Bistrica e Prizrenit është i ndenjtur me një tendencë të stagnimit dhe në rënie të vogël në katër ditët e ardhshme.
4. Niveli i ujit në Erenik është në rritje të lehtë, me një tendencë për rritje të moderuar në dy ditët e ardhshme.
5. Niveli i ujit në Lumin Mirusha është në kuotën e domenit të mesëm dhe të lartë, me tendencë të uljes së lehtë gjatë ditëve në vazhdim.
6. Sitnica është në rënie të vazhdueshme, niveli i ujit në stacionin hidrometrik Vragoli, më datë 09/02/2015, në ora 11<sup>00</sup> ishte 220 Cm, me tendenca të rënies së letë, e cila do të vazhdoj edhe gjatë ditëve në vazhdim, kjo rënie do të jetë prezente edhe në degët kryesore të sajë si në Lumin Llap, Drenica etj.
7. Morava e Binçës është në rinie të vazhdueshme, kjo tendencë do të vazhdoj edhe gjatë ditëve në vazhdim, kjo rënie do të jetë prezente edhe për degën e sajë më të rëndësishme nga ana e majtë Kriva Rekën me të gjitha rrjedhat e sajë.
8. Lepenci është në stagnim, gjatë ditëve në vazhdim do të ketë ulje graduale të nivelit të tij duke përfshi edhe Lumin e Nerodimës.

### ***Sqarim:***

**Përmbytje rregullt** deklarohet kur niveli i ujit në lumë arrin limitin e përcaktuar (e cila është e përcaktuar për secilin sektor uJOR) dhe ka tendencë të rritet më tej. Përmbytje e rregullt shpallet nga institucioni përgjegjës i cili njëherazi merret me menaxhim të ujit duke përfshi vëzhgimin e vazhdueshëm dhe monitorimin e argjinaturave dhe strukturave.

**Përmbytje e jashtëzakonshme** është shpallur kur niveli i ujit arrin limitin e përcaktuar dhe ka tendencë për tu rritur më tej, ose kur kërkohet nga arsye të tjera (kohëzgjatje e nivelit të ujit mbi kufirin e mbrojtjes të rregullt, kur gjendjen e digave dhe objekteve tjera, paraqitet e rrezikuar nga tejmbushja dhe tendenca e tejklimit të kapaciteteve) etj.

Në rastin e daljes nga shtrati ose përparim i pakontrolluar i shkallës së përmbytjeve, duke i tejkuluar pritrat dhe argjinaturat, shpallet gjendjen e jashtëzakonshme nga institucioni kompetent.

Gjendjen e jashtëzakonshme shpallet edhe nga komunat kompetente të rrezikuara dhe përfshin ndërtimin e argjinaturave lokalizuese, evakuimit dhe masa tjera.

Gjatë periudhës së përmbytjeve hidrologjike Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, prezanton informacionet e jashtëzakonshme hidrologjike, me dorëzimin e mëtejme të të dhënave hidrologjike dhe meteorologjike.